



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

DEGA VENDORE TIRANË

**NOTER ENKELEIDA I. HOXHA
ADRESA Lagjia NR.5, Rr.
BLV"BAJRAM CURRI", GODINA 1
MAJI, AP. NR.22, HYRJA 3
TEL: 0682035826**

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3674

Nr. koleksioni: 1074

Tirane më 29/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053570123593982



A2021053570123593982

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË "UTV EDUCATION" Sh.p.k.)

Sot, më datë 29.10.2021, para meje Notere **ENKELEIDA I. HOXHA**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Tirane, Lagjia NR.5, Rr. Blv "Bajram Curri", Godina 1 Maji, Ap. Nr.22, Hyrja 3, u paraqiten personalisht:

SHITES:

Astrit Veliaj, atësia Ferik, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Berat, me adresë Republika 00010002; Nd. 6; H. 3; Berat, lindur më 08/04/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033825706 dhe nr. personal F80408148C, ne cilesine e ortakut te vetem me 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "**UTV EDUCATION**" shpk me NUIS K31531673.

SHITËSE:

Adelina Veliaj, atësia Kristo, amësia Suzana, shtetase Shqiptare, lindur në Përmet dhe banuese në Tiranë, me adresë Jul Variboba; Nd. 2; H. 1; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 26/12/1971, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033845720 dhe nr. personal H16226128P. (Ne cilesine e bashkeshortes te pales shitese.)

BLERES:

Shoqëria "**PANORAMA GROUP**", regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K22112005E, me seli në Tirane, me adresë Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga Panorama, Pll.1, Kt.2, Ish Elektroteknike, përfaqësuar nga Administratori **Elidon Allaj**, atësia Hakim, amësia Vasilie, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, lindur më 05/05/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035378417 dhe nr. personal H70505218E, (referuar në vijim si "**Panorama Group**")

BLERES:

Shoqëria "**PANDA GROUP**", regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L53719002Q, me seli në Tirane, me adresë Lagjia 3, Shetitore Fan S. Noli, Objekti Nr. 1, përfaqësuar nga ortaku i vetem **Andrea Nako**, atësia Niko, amësia Shgabonje, shtetas Shqiptar, lindur në Panarit, Korçë dhe banues në Korce, lindur më 25/03/1970, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035813008 dhe nr. personal H00325059S, (referuar në vijim si "**Panda Group**")



A2021053570123593982

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "UTV EDUCATION" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

TË DHËNA PARAPRAKE:

- I. Z. Astrit Veliaj është ortak i vetem me 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "UTV EDUCATION" shpk me NUIS K31531673S (që këtu edhe 'shoqëria'). Është rënë dakort të bëhet shitja e 100% (njëqind përqind) te kuotave qe z. Astrit Veliaj zotëron te Shoqëria "UTV EDUCATION" shpk tek blerësit Shoqëria "Panorama Group" sha dhe Shoqëria "Panda Group" shpk, konkretisht:
- Shoqëria "Panorama Group" sha, blerës i 40% të kuotave të Shoqërisë.
 - Shoqëria "Panda Group" shpk, blerës i 60% të kuotave të Shoqërisë.
- II. Blerësit bëhen ortakë të shoqërise me 100% te kuotave, sipas përqindjeve konkrete si më sipër.
- III. Në bazë të udhëzimit nr. 2007/1, datë 2.3.2010, të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është kërkuar informacion nga noteri sipas njoftimit pranë Regjistrimit të Barrëve Siguruese dhe nga përgjigjia e dhënë nga RBS, rezulton se mbi kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë "UTV EDUCATION" shpk nuk rezulton asnjë barrë siguruese.

NENI 1 Objekti

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave të individualizuara nga shitësi tek blerësit kundrejt çmimit të përcaktuar në Nenin 2 të kësaj kontrate.


NENI 2 Çmimi

- 2.1. Shitësi ia shet këto kuota blerësve kundrejt një çmimi 10,000,000 (dhjete milion) lekë, konkretisht:
- Shoqëria "Panorama Group" sha, blerës i 40% të kuotave të shoqërisë në vlerën 4,000,000 (katër milion) lekë, e cila do të paguhet brenda 1 (një) viti nga nënshkrimi i kontratës.
 - Shoqëria "Panda Group" shpk, blerës i 60% të kuotave të shoqërisë në vlerën 6,000,000 (gjashtë milion) lekë.
- 2.2. Palët deklarojnë se çmimi do të paguhet nga Blerësit në llogarinë bankare të shitësit me të dhëna:

BANKA ALPHA BANK



IBAN AL38902112090202030057111402



NENI 3 Kalimi i pronësisë

1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, blëresve i kalon pronësia mbi kuotat e blera menjehere, te lira dhe pa barrë.
2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi Z. Astrit Veliaj zhvishet nga pronësia e kuotave dhe bleresit:
 - a. Shoqëria "Panorama Group" sha, bëhet ortak i 40% të kuotave të Shoqërisë.
 - b. Shoqëria "Panda Group" shpk, bëhet ortak i 60% të kuotave të Shoqërisë.
3. Pronësia e kalimit të 100% të kuotave nga shitësi tek blerësit do të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe blerësve ju lind e drejta e regjistrimit në QKB të kësaj kontrate të kalimit të 100% të kuotave menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

NENI 4 Deklarime dhe Garanci të Shitësit

Shitësi deklaron dhe garanton qe deklaramet dhe çeshtjet te percaktuara ne këtë nen jane te verteta dhe te sakta.

4.1 Organizimi

Shoqëria "UTV EDUCATION" shpk eshte nje shoqeri ekzistuese e vlefshme, e organizuar rregullisht dhe themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe nuk eshte ne gjendje paaftesie paguese apo falimentimi, nuk eshte subjekt likuidimi apo ne procedura prishjeje dhe ka kompetencen dhe autoritetin e plote per te menaxhuar aktivitetin e shoqerise dhe pronat e saj. Shoqëria "UTV EDUCATION" shpk eshte pajisur me te gjitha licencat, lejet, autorizimet thelbesore dhe pelqimet e kerkuara per kryerjen e aktivitetit te shoqerise. Shoqëria "UTV EDUCATION" shpk operon ne perputhje me ligjet e zbatueshme, me gjykimet, dekrete e çdo gjykate, komisioni apo çdo Autoriteti Shteteror.

4.2 Autoriteti per te hyre ne kete Marreveshjeje

Shitësi ka pushtetin dhe autoritetin e plote per te zbatuar Kontratën dhe Dokumentet e Transaksionit ne te cilen ai eshte pale, dhe perveç rasteve qe parashikohet ndryshe, nuk eshte e nevojshme per te kryer veprime te metejshme nga Shitësi per ta bere kete Kontratë te vlefshme, te detyrueshme dhe te zbatueshme perkundrejt tij ne perputhje me afatet e parashikuar ne kete Kontratë. Per ekzekutimin dhe dorezimin e Marreveshjes ose kryerjen e detyrimeve te Shitësit ne vijim, nuk eshte e nevojshme per pelqimin, aprovimin, urdher, lejim ose autorizim, heqje dore, me deklarim ose njoftim te asnje Autoriteti Shteteror, perveç atyre qe ne menyre te qarte jane parashikuar ne kete Marreveshje.

4.2.1 Pronesia

- Shitësi eshte pronar i vetem, ligjore dhe perfitues i Kuotave te "UTV EDUCATION" shpk objekt shitje.
- Kuotat e "UTV EDUCATION" shpk jane te paguara plotesisht.



A2021053570123593982

- Kuotat e "UTV EDUCATION" shpk nuk janë të vendosura peng apo mbi to ka ndonjë opsion ose e drejtë tjetërsimi ose barrësimi dhe nëse janë të bllokuara në çdo moment gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, nga ana e Shitësit do të kryhen të gjitha veprimet e nevojshme për lirimin e tyre tërësisht përpara kalimit të çmimit të kuotave nga Blerësi tek Shitësi.

Në rast se, gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, kuotat e "UTV EDUCATION" shpk, bllokohen për çfarëdo shkak apo arsyeje, Blerësi ka të drejtë të pezullojë pagesat deri në lirimin e kuotave objekt shitje nga Shitësi dhe çdo vonesë për këtë shkak nuk do të llogaritet në afatet e kësaj kontrate.

- Shitësi, në cilësinë e Ortakut dhe/ose anëtari në organet drejtuese të "UTV EDUCATION" shpk, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje garanton se nuk do të kryejë asnjë veprim i cili pakëson vlerën e kuotave dhe pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të "UTV EDUCATION" shpk, duke përfshirë por pa u kufizuar në: tjetërsimin e pasurive të paluajtshme, tjetërsimin e pasurive të luajtshme, faljen e kredive që "UTV EDUCATION" shpk ka në palë të treta, kryerja e veprimeve të cilat mund të përkeqësojnë situatën financiare afatshkurtër ose afatgjatë të "UTV EDUCATION" shpk.

- Shitësi deklaron dhe garanton se llogaria e tij bankare prane bankës ku do të paguhet cmimi i shitjes është dhe do të jete e lire nga cdo barre, peng, pretendim i te treteve dhe se ai, aktualisht dhe ne te ardhmen, nuk është ne vonese, nuk ka asnje detyrim te papaguar dhe nuk ka dijeni per asnje rrethane apo ngjarje qe mund te sjelle bllokimin dhe/ose sekuestrimin e shumave te depozituara ne llogarite e tij nga ndonje kreditor apo ndonje organ shteteror, gje qe mund te pengoje permbushjen e kushteve te kesaj kontrate.

- Shitësi deklaron se per shitjen e kuotave te "UTV EDUCATION" shpk objekt kontrate ka marre pelqimin paraprak te bashkeshortes se tij, dhe z. Astrit Veliaj dhe znj. Adelina Veliaj garanton Bleresin se me nenshkrimin e kesaj kontrate, nuk do te kete asnje pretendim tani dhe ne te ardhmen nga ana e personave te tjere te lidhur me ta, ne lidhje me kete transakcion dhe/ose ne lidhje me cdo parashikim te kesaj kontrate.

4.3 Gjendja financiare dhe aktiviteti i "UTV EDUCATION" shpk

Te gjitha dokumentet ne lidhje me shoqerine "UTV EDUCATION" shpk te kerkuar nga Bleresi do të vendosen ne dispozicion te Bleresit dhe asnje nga dokumentet thelbësore nuk do t'i privohet Bleresit dhe veçanerisht te gjitha kopjet e dokumentacionit te bera disponueshme jane nje kopje e vertete e dokumentit original dhe gjetjet reflektojne gjendjen e sakte te aktivitetit te shoqerise "UTV EDUCATION" shpk. Ne dijenine e Shitësit, nuk ka fakte ose çeshtje mungesa e te cilave ben çorientuese ndonje nga Garancite e Shitesit ose qe ne menyre te arsyeshme do te mund te ndikonte ne gjykimin e Bleresit ne lidhje me blerjen e Kuotave te "UTV EDUCATION" shpk sipas kushteve te kesaj Kontrate.

Në veçanti Shitësi garanton se të gjitha liçencat, autorizimet, lejet apo akte të tjera të cilat janë lëshuar nga organet kompetente shtetërore apo private, do të vijojnë të ngelen në emër të shoqërisë "UTV EDUCATION" shpk edhe pas kalimit të pronësis sipas kësaj kontrate.



A2021053570123593982

NENI 5 **Konfidencialiteti**

Ne perputhje me kete Marreveshje, secili nga Shitesi dhe Bleresi nuk duhet te bejne me dije Informacione Konfidenciale paleve te treta pa marre nje miratim paraprak te shkruar nga pala tjeter. Detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet per informacionet konfidenciale qe i behen me dije organeve menaxhuese te Bleresit, punemarresve, drejtoreve, keshilltareve ose agjenteve te pales ne nevoje per te njohur bazen, me kusht qe pala tjeter ne çdo rast do te mbaje pergjegjesi per çdo shkelje te detyrimeve sipas klauzoles.

Perveç kesaj, detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet ne rast se Pales i kerkohet sipas ligjit te zbatueshem, ose vendimi gjyqesor dhe administrativ qe te bej te ditur informacionin paleve te treta. Sidoqofte ne keto raste vetem ne masen e parashikuar nga ligji i zbatueshem, vendimi gjyqesor ose administrative do te behet me dije. Me perjashtim te parashikimeve te mesiperme, çdo pale duhet jap çdo Informacion Konfidencial Autoriteteve Qeveritare/Shteterore ne Shqiperi dhe çdo juridiksioni dhe juridiksioneve perkatese per aq sa eshte e nevojshme, arsyeshme per te

permbushur kushtet paraprake dhe ose detyrimet te tjera te permbajtura ne Marreveshjen.

NENI 6 **Të ndryshme**

6.1 Palët u porositën që të depozitojnë kontratën pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit për të bërë regjistrimet përkatëse.

6.2 Shpenzimet noteriale do të paguhen nga Shitesi.

6.3 Kjo kontrate është hartuar në bazë te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës se Shqipërisë. Çështjet që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil.

6.4 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate do të zgjidhen me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Kontrata iu lexohet palëve te cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë"

Kontrata redaktohet në pesë (5) kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilat një kopje ruhet në arkivin e noteres.



A2021053570123593982

Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimeve, në bazë të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë"



PALET KONTRAKTUESE



**SHITESI
ASTRIT VELIAJ**

Astrit Veliaj

**BLERESIT
"PANORAMA GROUP" Sh.a.
ELIDON ALIAJ**

Elidon Aliaj



ADELINA VELIAJ

Adelina Veliaj

**"PANDA GROUP" SH.p.k.
ANDREA NAKO**

Andrea Nako

PANDA GRUP SH.P.K.
NIPT: L537190020
TEL: 082254032
KORÇE

NOTERE

ENKELEIDA I. HOXHA

Enkeleida I. Hoxha



Notere
Enkeleida Hoxha
NIPT: K41517018D
CEL: +355 6820 35 826

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2021102910423648
Data e Rezultatit të Kërkimit: 29.10.2021
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 10:42:36AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-105-1378
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

UTV EDUCATION SH.P.K.



Valbona Jola